FEDERATA E SPORTEVE UNIVERSITARE E KOSOVËS
KOSOVO UNIVERSITY SPORTS FEDERATION

Kuvendi i Anëtarëve të Federatës së Sporteve Universitare të Kosovës (FSUNK), në mbledhjem e Jashtëzakonshme të tij, të mbajtur më datë 28.03.2025, duke u bazuar në kompetencat e përcakutara me Statutin e FSUNK-së, mori këtë

VENDIM

I. Aprovohet Kërkesa e Shoqatës së Sporteve Universitare – Universiteti "Isa Boletini" Mitrovicë, datë 19.03.2025.

II. Shoqata e Sporteve Universitare – Universiteti "Isa Boletini" Mitrovicë, anëtarësohet, respektivisht pranohet si anëtare me të drejta të plota në Federatën e Sporteve Universitare të Kosovës.

III. Ky vendim hynë në fuqi nga dita e miratimit nga Kuvendi i Jashtëzakonshëm i FSUNK-së, datë 28.03.2025.

Arsyetim

Më datën 20.03.2025, Federata e Sporteve Universitare e Kosovës, ka pranuar Kërkesën e Shoqatës së Sporteve Universitare – Universiteti "Isa Boletini" Mitrovicë, për anëtarësim në FSUNK. Kërkesa si e tillë i është drejtuar Kuvendit të FSUNK-së, nëpërmjet Bordit Ekzekutiv, përkitazi me përcaktimet e Statutit FSUNK-së. FSUNK, duke ndjekur procedurat e përcaktuara më Statutin saj, nëpërmjet Bordit Ekzekutiv, Kërkesën përkatëse, nëpërmjet email-it, e ka përcjellë paraprakisht tek delegatët e anëtarëve të Kuvendit. Kërkesa si e tillë, në Kuvendin e Jashtëzakonshëm të datës 28.03.2025,u hodh për votim, me c'rast u miratua me aklamacion nga të gjithë anëtarët prezent. Andaj, duke u bazuar në atë që u tha më lart, Kuvendi vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi t'u dërgohet:

- Shoqatës Universitare – Universiteti "Isa Boletini" Mitrovicë,
- Anëtarëve të Kuvendit të FSUNK-së,
- Bordit Ekzekutiv,
- MKRS-së dhe
- Arkivit të FSUNK-së.

Kryetari i FSUNK-së,

Prof. Asoc. Dr. Musa Selimi